

Informatë për ecurinë e hartimit të PZHK-së e dhënë në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Rahovecit të mbajtur me datë 30 Maj 2018

Asambleja komunale vitin e kaluar, me 31 mars ka marrë vendim për hartimin e planit të ri zhvillimor komunal si dhe ka miratuar programin e punës për hartimin dhe menaxhimin e PZHK-së.

Plani Zhvillimor është dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit të një komune, është plan multi-sektorial që planifikon në një afat prej 8 vite të gjitha aspektet e zhvillimit komunal.

Në si qeveri komunale kemi zhvilluar të gjitha procedurat që të hartojmë një Plan Zhvillimor më përmbajtjesor, më të qëndrueshëm si dhe më të zbatueshëm.

Në bazë të Planit, të miratuar në Kuvend, Komuna e Rahovecit ka shpallur tenderin si dhe është lidhur kontrata me studion e arkitekturës dhe planifikimit hapësinor "Prima Engineering" në mbështetje të Komunës së Rahovecit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Bartëse e kësaj kontrate është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, si organ përgjegjës për planifikim në komunën e Rahovecit.

Me datë 27 mars të këtij viti, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka formuar Komitetin Drejtues për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në përbërje të të gjithë drejtorëve të Drejtorive Komunale si dhe stafit të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtës së Mjedisit. Koordinator i Komitetit Drejtues për hartimin e PZHK-së është caktuar nënkryetari i Komunës së Rahovecit, Fatmir Iska.

Me 29 mars, Komiteti Drejtues ka mbajtur takimin e parë dhe është kërkuar nga të gjithë drejtorët e Drejtorive sektoriale që t'i mbledhin të dhënat ekzistuese të drejtorive që i udhëheqin dhe t'i dërgojnë në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, si përgjegjëse për projektin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Tani jemi në fazën e mbledhjes së të dhënave ekzistuese dhe do të vazhdojmë sipas planit të parapare për hartimin e PZHK-së.

Rumir Zhuniqi

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit